

A K T T H E M E L I M I

Bot në datën 25 gusht 1996 në Korçë ne ortakët :

- 1) BENITO AZIZI, i biri i Urimit, i datëlindjes 1964, banues në Korçë
- 2) HASAN IBRAHIMI, i biri i Safetit, i datëlindjes 1964, banues në Korçë
- 3) ROMEO SARAÇI, i biri i Nikos, i datëlindjes 1942, banues në Korçë
- 4) PIRO SARAÇI, i biri i Nikos, i datëlindjes 1948, banues në Korçë
- 5) GJERGJI BELLO, i biri i Avniut, i datëlindjes 1963, banues në Korçë
- 6) GËZIM DVORANI, i biri i Aliut, i datëlindjes 1959, banues në Korçë
- 7) BUJAR GJATA, i biri i Enverit, i datëlindjes 1950, banues në Korçë
- 8) GJERGJI ÇOBO, i biri i Esatit, i datëlindjes 1956, banues në Korçë
- 9) ARTAN HAMZAJ, i biri i Haxhiut, i datëlindjes 1965, banues në Korçë
- 10) BARDHYL META, i biri i Nebiut, i datëlindjes 1961, banues në Korçë
- 11) MAKSI MARKO, i biri i Petros, i datëlindjes 1958, banues në Korçë
- 12) PANDI BEBA, i biri i Sotirit, i datëlindjes 1940, banues në Korçë
- 13) PIRO NASTO, i biri i Sotirit, i datëlindjes 1941, banues në Korçë
- 14) AGRON MUÇOLLARI, i biri i Shefqetit, i datëlindjes 1955, banues në Korçë
- 15) SKËNDER FEKA, i biri i Muhametit, i datëlindjes 1959, banues në Korçë

themelojmë Shoqërinë private "START-KORÇA" Sh.p.k.

Selia e kësaj Shoqërie është në qytetin e Korçës, Lagjia 18, Bulevardi "Gjergj Kastrioti" Pallati 9/6 dhe teritori i ushtrimit të veprimtarisë së saj e gjithë Republika e Shqipërisë dhe jashtë saj.

Kapitali themelues i kësaj Shoqërie përbëhet prej 130,000 lek, me pje nga 10.000 lek= 7,692% për 11 ortakë (B.Azizi, H.Ibrahimi, Gj.Bello, G.Dvorani, B.Gjata, Gj.Çobo, A.Hamzaj, B.Meta, M.Marko, A.Muçollari, S.Feka) dhe nga 5.000 lek= 3,846% për 4 ortakë (R.Saraçi, P.Saraçi, P.Beba, P.Nasto).

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj me 13 autobuzë:

- 1) Benito Azizi një autobus tip "Benz 302" me targë KO 2539 A dhe me vlerë 1.800.000 lek.
- 2) Hasan Ibrahimi një autobus tip "Karosa" me targë KO 3192 A dhe me vlerë 1.300.000 lek.
- 3) Piro dhe Romeo Saraçi një autobus tip "Karosa" me targë KO 3137 A dhe me vlerë 1.000.000 lek.
- 4) Gjergji Bello një autobus tip "Benz 303" me targë KO 0463 A dhe me vlerë 1.000.000 lek.
- 5) Gëzim Dvorani një autobus tip "Fiat 309" me targë KO 3883 A dhe me vlerë 1.000.000 lek.
- 6) Bujar Gjata një autobus tip "Fiat" me targë KO 3064 A dhe me vlerë 700.000 lek.
- 7) Gjergji Çobo një autobus tip "Benz 302" me targë KO 2478 A dhe me vlerë 1.800.000 lek.
- 8) Artan Hamzaj një autobus tip "Fiat Iveko" me targë KO 2565 A dhe me vlerë 1.300.000 lek.
- 9) Bardhyl Meta një autobus tip "Karosa" me targë KO 3187 A dhe me vlerë 1.150.000 lek.



- 10) Maksi Marko një autobus tip "Magirus" me targë KO 2260 A dhe me vlerë 600.000 lek.
- Agron Muçollari një autobus tip "Benz 303" me targë KO 2061 A dhe me vlerë 1.800.000 lek.
- 12) Pandi Beba dhe Piro Nasto një autobus tip "Setra" me targë KO 1052 A dhe me vlerë 700.000 lek.
- 13) Skënder Feka një autobus tip "Karosa" me targë KO 2804 A dhe me vlerë 670.000 lek.

Objekti i kësaj Shoqërie private është kryerja e shërbimit inter-urban e urban të udhëtarëve vendas e të huaj brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, përfshirë në fushën e transportit të udhëtarëve bagazheve të tyre dhe mallrave, por gjithmonë duke zbatuar legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

Afati i ushtrimit të veprimtarisë është mbi 10 vjet pandërprerje. Të gjitha të ardhurat që do të rezultojnë pas zbritjes së shpenzimeve dhe zbritjeve të tjera sipas ligjit do të ndahen midis ortakëve themelues në raport me të ardhurat e realizuara nga secili prej tyre me mjetin e vet.

Administrator i Shoqërisë u caktua Zoti ROMEO NIKO SARAÇI.

Ky Akt Themelimi u lexua nga ortakët dhe si u pa që është i njëjt me dëshirën dhe vullnetin e tyre, u nënshkrua rregullisht nga të gjithë ortakët themelues.

ORTAKËT THEMELUES :

- |                   |                     |
|-------------------|---------------------|
| 1) BENITO AZIZI   | 9) ARTAN HAMZAJ     |
| 2) HASAN IBRAHIMI | 10) BARDHYL META    |
| 3) PIRO SARAÇI    | 11) MAKSI MARKO     |
| 4) ROMEO SARAÇI   | 12) AGRON MUÇOLLARI |
| 5) GËZIM DVORANI  | 13) PANDI BEBA      |
| 6), GJERGJI BELLO | 14) PIRO NASTO      |
| 7) BUJAR GJATA    | 15) SKËNDER FEKA    |
| 8) GJERGJI ÇOBO   |                     |

S T A T U T I

I SHOQËRISË PRIVATE " START - KORÇA " Sh.p.k.

Në bazë të Aktit të Themelimit datë 25.08.1996 ortakët themelues Benito Azizi, Hasan Ibrahim, Piro e Romeo Saraçi, Gjergji Bello, Gëzim Dvorani, Bujar Gjata, Gjergji Çobo, Artan Hamzaj, Bardhyl Meta, Maksim Marko, Agron Muçollari, Pandi Beba e Piro Nasto dhe Skënder Feka kanë themeluar Shoqërinë private "START-KORÇA" Sh.p.k.

Në mirëkuptim të plotë me njëri tjetrin ata vendosën së bashku që kjo Shoqëri të punojë në mbështetje të rregullave të përcaktuara në këtë Statut, të cilin e miratojnë njëzëri:

K R E U I I

"EMRI, VENDNDODHJA, KOHËZGJATJA DHE OBJEKTI I VEPRIMTARISË"

N e n i 1

Emri i Shoqërisë private me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K.) të themeluar nga ortakët e sipërm është "START-KORÇA" Sh.p.k.

N e n i 2

Selia e Shoqërisë "START-KORÇA" Sh.p.k. është në qytetin e Korçës, ku është dhe vendbanimi i të gjithë ortakëve themelues të saj.

Për të realizuar qëllimin e saj ajo mund të hapë filiale të veta edhe në qytete të tjera të Shqipërisë.

N e n i 3

Shoqëria private "START-KORÇA" Sh.p.k. do të ushtrojë veprimtarinë e saj private në të gjithë territorin e Shqipërisë dhe jashtë tij.

N e n i 4

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë "START-KORÇA" Sh.p.k. është mbi 10 vjet pandërprerje. Ky afat mund të zgjatet më tej ose mund të shkurohet me vendim të ortakëve themelues të saj me jo më pak se 3/4 e tyre.

N e n i 5

Objekt i veprimtarisë private të Shoqërisë "START-KORÇA" Sh.p.k. është të kryerja e shërbimit interurban e urban të udhëtarëve vendas e të huaja, brënda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, përfaqësimi në fushën e transportit të udhëtarëve, bagazheve të tyre dhe mallrave, por gjithmonë duke zbatuar legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria synon mbrojtjen e interesave të promarëve të autobuzëve private.

K R E U I DYTË

" KAPITALI I SHOQËRISË "

N e n i 6

Kapitali i Shoqërisë private "START-KORÇA" Sh.p.k. përbëhet nga :  
= Kapitali financiar i Shoqërisë në masën 130.000 (njëqintetridhjetmijë) lekë, i cili është kontributi i përbashkët i 13 anëtarëve ortakë themelues të saj në kuota të barabarta prej 10.000 (dhjetëmijë) lek secili (11 ortakë dhe 5000 lek (4 ortakë). %



Kapitali në natyrë, në përbërje të të cilit përfshihet vlera e autobusëve të secilit ortak si më poshtë:

- 1) Një autobus i tipit "BENZ 302" me vlerë 1.800.000 lek, me targë KO 2539 A, pronë e Z. Benito Azizi.
- 2) Një autobus i tipit "KAROSA" me vlerë 1.300.000 lek, me targë KO 3192 pronë e Z. Hasan Ibrahim.
- 3) Një autobus i tipit "KAROSA" me vlerë 1.000.000 lek, me targë KO 3137 A pronë e Z. Piro dhe Romeo Saraçi.
- 4) Një autobus i tipit "BENZ 303" me vlerë 1.000.000 lek, me targë KO 046 A, pronë e Z. Gjergji Bello.
- 5) Një autobus i tipit "FIAT 309" me vlerë 1.000.000 lek, me targë KO 38 A, pronë e Z. Gëzim Dvorani.
- 6) Një autobus i tipit "FIAT" me vlerë 700.000 lek, me targë KO 3064 A, pronë e Z. Gujar Gjata.
- 7) Një autobus i tipit "BENZ 302" me vlerë 1.800.000, me targë KO 2478 A pronë e Z. Gjergji Çobo.
- 8) Një autobus i tipit "FIAT IVEKO" me vlerë 1.300.000 lek, me targë KO 65 A, pronë e Z. Artan Hamza.
- 9) Një autobus i tipit "KAROSA" me vlerë 1.150.000 lek, me targë KO 318 pronë e Z. Bardhyl Meta.
- 10) Një autobus i tipit "MAGIRUS" me vlerë 600.000 lek, me targë KO 2260 pronë e Z. Maksim Marko.
- 11) Një autobus i tipit "BENZ 303" me vlerë 1.800.000 lek, me targë KO 2 A, pronë e Z. Agron Muçollari.
- 12) Një autobus i tipit "SETRA" me vlerë 700.000 lek, me targë KO 1052 A pronë e Z. Pandi Beba dhe Piro Nasto.
- 13) Një autobus i tipit "KAROSA" me vlerë 670.000 lek, me targë KO 280 pronë e Z. Skënder Feka.

Me zgjerimin e aktivitetit dhe me vendim të ortakëve themelues të Shoqërisë mund të shtohet edhe kapitali themelues i saj nëpërmjet shtimit të kapitalit financiar prej 10.000 (dhjetëmijë) lek dhe vlerës së autokapitalit për çdo ortak të ri të pranuar me vendim të jo më pak se 3/4 të ortakëve themelues të "START-KORÇA" Sh.p.k.

N e n i 7

Transferimi i kapitalit fillestar bëhet me vendim të ortakëve themelues të Shoqërisë dhe me Akt noterial. Pjesët e kapitalit fillestar janë të transferueshme edhe në rrugë trashëgimie.

N e n i 8

Pjesët e kapitalit të themelimit mund t'u transferohen edhe anëtarëve të tretë që nuk bëjnë pjesë në këtë Shoqëri.

N e n i 9

Të gjitha rastet e transferimit të kapitalit (me vendim të ortakëve themelues të Shoqërisë, me Akt noterial, në rrugë trashëgimie apo në

NOJËR  
KORÇA

(rast tjetër) nuk përcaktojnë pjesëmarrje të detyrueshme në Shoqërinë "START-KORÇA" Sh.p.k. të përfituesit të ri të kapitalit.

Është e drejtë ekskluzive vetëm e ortakëve themelues të Shoqërisë për caktimi i qëndrimit ose jo në përbërje të Shoqërisë të përfituesit të ri të kapitalit të transferueshëm, përcaktim ky që bëhet me vendim të jo më pak se 3/4 e ortakëve themelues të Shoqërisë.

N e n i 10

Në Shoqërinë private "START-KORÇA" Sh.p.k. mund të pranohen edhe ortakë të tjerë, të cilët do të bashkojnë kapitalet e tyre me ato të Shoqërisë.

Në çdo rast pranimi i ortakëve të rinj është e drejtë ekskluzive vetëm e ortakëve themelues të Shoqërisë "START-KORÇA" Sh.p.k., duke respektuar rregullat e përcaktuara në nenin 6 dhe 9 të këtij Statuti.

K R E U I T R E T Ë  
" ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I SHOQËRISË "

N e n i 11

Shoqëria "START-KORÇA" Sh.p.k. deklarohej e krijuar në zbatim të normave që përmban ky Statut, Akti i themelimit dhe ato pjesë të legjislativnit në fuqi, veçanërisht të Ligjit nr.7512 datë 10.8.91 dhe nr.7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë Tregëtare".

N e n i 12

Shoqëria ka vulën e vet të identifikimit, e cila përmban detyrimisht emërtimin e Shoqërisë "START-KORÇA" Sh.p.k.

Vula ka fuqi ligjore vetëm kur vendoset përbri nënshkrimit të ortakëve themelues, të Administratorit gjatë ushtrimit të funksjonit të tij në dokumentat e Shoqërisë.

Vula vendoset vetëm për probleme që kanë të bëjnë me Shoqërinë "START-KORÇA" Sh.p.k. dhe veprimtarinë e saj.

N e n i 13

Shoqëria vepron me rregjimin e pronës private dhe merr përsipër të drejta dhe detyrime. Ajo përgjigjet për detyrimet e saj kontraktore dhe jashtë kontraktore vetëm brenda kapitalit të saj nëpërmjet përgjegjësisë çdo ortaku për pjesën e kapitalit të tij. Çdo pronar ortak i Shoqërisë bart rrezikun e veprimtarisë së tij në nivelin e mjeteve të tij të bashkuara në kapital (nga vetë termi Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar = Sh.p.k.)

N e n i 14

Shoqëria "START-KORÇA" Sh.p.k. do të drejtohet nga :

- 1.- Asambleja e ortakëve
- 2.- Administratori i Shoqërisë

N e n i 15

Asambleja e ortakëve është organi vendimor i Shoqërisë dhe përbëhet nga ortakët themelues të Shoqërisë, nga ortakët që i shtohen asaj gjatë veprimtarisë së saj dhe nga ortakët të tjerë të bashkuar në kapital (me të drejtë vote) dhe nga aktivitetit me vendim të ortakëve themelues (me të drejtë vote) dhe nga

shprehjet e punësuar (pa të drejtë vote).

Ajo mbledhet në Selinë e Shoqërisë jo më pak se një herë në 3 muajt e thirrret nga administratori i saj nëpërmjet njoftimit me shkrim.

Vendimet në Asamble merren për çdo problem që i intereson Shoqërisë me shumicë votash (me më shumë se 50%), me përjashtim të vendimeve që lidhen me nenet 6, 9, 10 dhe 17 (pika 1, 2, 8, 9, 10, 12 dhe 15) të këtij Statuti, të cilat janë e drejtë ekskluzive vetëm të ortakëve themelues të Shoqërisë "START-KORÇA" Sh.p.k. dhe merren sipas përcaktimeve të bëra në këto nene.

Vendimet e Asamblesë së ortakëve protokollohen dhe nënshkruhen nga çdo ortak pjesëmarrës në votim.

N e n i 16

Vendimet e Asamblesë së ortakëve të mara sipas nenit 15 më lart dhe legjisllacionit në fuqi janë të detyrueshme për çdo ortak dhe për të punësuarit në Shoqërinë "START-KORÇA" Sh.p.k.

N e n i 17

Asambleja e ortakëve ka të drejtën e njohjes dhe trajtimit të çdo problemi që ka të bëjë me Shoqërinë. Ajo ka këto kompetenca:

- \* 1.- Miraton Statutin, dokumentat themeluese të Shoqërisë dhe ndryshimet në to.
- \* 2.- Zgjedh midis ortakëve Administratorin e Shoqërisë dhe e shkarkon atë për shkelje të qëllimëshme të dokumentave themeluese të Shoqërisë ose për abuzime në dëm të saj gjatë kryerjes së detyrës prej tij.
- 3.- Vendos për aktivitetin e Shoqërisë, zgjerimin ose zvogëlimin e tij.
- 4.- Vendos për garancitë që lidhen me të tretët.
- 5.- Vendos për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera ose për heqjen dorë prej tyre.
- 6.- Vendos për marrjen e kredive ose kuave dhe për dhënien e tyre.
- 7.- Vendos për nënshkrimin e kontratave dhe për lidhjen e kontratave të reja me afat mbi 1 vit.
- \* 8.- Vendos për qëndrimin që duhet mbajtur ndaj ortakëve të rinj që rrjedhin nga transferimi i kapitalit.
- \* 9.- Vendos për pranimin në Shoqëri të ortakëve të rinj.
- \* 10.- Vendos për zgjatjen e kohëzgjatjes së veprimtarisë të Shoqërisë dhe shpërndarjen e saj.
- 11.- Miraton aktivitetin e Shoqërisë për çdo vit ushtrimor, bilancin e aktivitetit të saj ekonomiko-financiar dhe shpërndarjen e fitimit.
- \* 12.- Vendos për rritjen ose pakësimin e kapitalit themeltar.
- 13.- Aprovon programin vjetor të aktivitetit të Shoqërisë.
- 14.- Cakton ekspertin kontabël të Shoqërisë.
- \* 15.- Vendos për marrjen me kontratë të përkohëshme të automjeteve të tjera që nuk janë në Shoqëri për përballimin e volumeve të punës, pa i anëtarësuar ata si ortakë të Shoqërisë.

Kompetencat e përcaktuara në këtë nen në pikat 1, 2, 8, 9, 10,

NOTER  
KORÇA

dhe 15 (me shënjen ✕) janë kompetenca ekskluzive vetëm e ortakëve themelues të Shoqërisë "START-KORÇA" Sh.p.k. dhe miratohen me vendim të jo më pak se 3/4 të ortakëve themelues.

#### N e n i 18

Me vendim të ortakëve themelues të Shoqërisë "START-KORÇA" Sh.p.k. është zgjedhur Administrator i saj Z. ROMEO NIKO SARAÇI me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 17.

Administratori ka të gjitha kompetencat që përcaktohen në nenet 50 dhe 57 të Ligjit nr.7638 datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregëtare" dhe të gjitha detyrimet që lindin prej tij, me përjashtim të kompetencave ekskluzive të Asamblesë të përcaktuara në nenin 17 të këtij Statuti.

Administratori kryen në punën e tij ato veprime që i gjykon të nevojshme konform ligjeve dhe që janë vetëm në interes të Shoqërisë për plotësimin e objektit të punës dhe zgjerimin e fitimit.

Ai dokumenton hollësisht punën e tij.

#### N e n i 19

Administratori është përgjegjës individual ndaj Shoqërisë dhe të ortakëve të tjerë për shkelje të ligjeve dhe për veprime në kundërshtim me Statutin dhe Aktin e Themelimit të **Shoqërisë**.

Ai e humbet detyrën e tij në rastin e prishjes së Shoqërisë ose me vendim të ortakëve themelues të saj kur shkel qëllimisht dokumentat themeluese të Shoqërisë ose abuzon në dëm të saj gjatë kryerjes së detyrës për të cilën është detyruar të punojë.

#### N e n i 20

Gjatë punës për organizimin dhe drejtimin e Shoqërisë Administratori ka këto kompetenca:

a.- Disponon firmë të parë në llogarinë bankare të Shoqërisë dhe ndjek të gjitha problemet financiare të saj.

b.- Mban kontabilitetin e Shoqërisë dhe nxjerr bilancin e saj (dhe të çdo ortaku të veçantë) në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kërkesat e ligjit nr.7661 datë 19.I.1993 "Për kontabilitetin" e të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.334 datë 9/7/1993 "**Për miratimin e planit kontabël të përgjithshëm**".

c.- Harton grafikët mujorë të lëvizjes së automjeteve sipas linjave që disponon Shoqëria me liçenca të rregullta.

d.- Përfaqëson Shoqërinë në marrëdhënie me të tretët, me shtetin dhe me çdo partner të vëndit e të huaj në veprimtarinë normale të saj apo në konfliktet gjyqësore.

e.- Kryen në kohë dhe me cilësi të gjitha veprimet për likuidimet ndaj sistemit fiskal.

f.- Administron dhe ruan vulën dhe dokumentacionin zyrtar e financiar të Shoqërisë sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

g.- Përpilon dhe administron dokumentacionin e punësimit të të punësuarve

(kontratat e punës) sipas marrëveshjeve të bëra midis pronarëve të automjeteve dhe të punësuarve prej tyre. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve midis tyre nuk është kompetencë e Administratorit por e pronarit dhe të punësuarit prej tij.

h.- Merr masa ose i propozon Asamblesë masa disiplinore ndaj ortakëve e punonjësve të punësuar prej tyre për rastet e shkeljes së rregullave të përcaktuara në dokumentat themeluese të Shoqërisë, të legjisllacionit në fuqi dhe të kapitullit "Organizimi i brëndëshëm i Shoqërisë" në fund të këtij Statuti.

K R E U I K A T È R T  
" P È R F A Q È S I M I D H E K O N T R O L L I I S H O Q È R I S È "

N e n i 21

Shoqëria "START-KORÇA" Sh.p.k. përfaqësohet nga ortakët themelues të saj, nga Administratori ose nga një person tjetër i autorizuar nga ortakët themelues me prokurë të posaçme.

Gjatë përfaqësimit të Shoqërisë Administratori ose çdo person tjetër i autorizuar prej ortakëve themelues kanë kompetencë të zbatojnë të gjitha rregullat dhe udhëzimet e dhëna prej ortakëve themelues në Aktin e përfaqësimit apo në P/verbale të veçanta.

N e n i 22

Ortakët themelues kanë të drejtë të caktojnë kontrollorët e Shoqërisë. Po ashtu ata caktojnë ekspertët kontabël për veprimtarinë ekonomike dhe financiare të Shoqërisë.

Pagat e kontrollorëve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar caktohen me vendim të ortakëve themelues të Shoqërisë, duke u mbështetur në dispozitat ligjore në fuqi.

K R E U I P E S T È  
" B I L A N C I D H E T È A R D H U R A T E S H O Q È R I S È "

N e n i 23

Veprimtaria ekonomike dhe financiare e Shoqërisë përputhet me vitin kalendarik. Ajo fillon çdo vit më 1 janar dhe mbyllet më 31 dhjetor të çdo viti.

Në fund të çdo periudhe ushtrimore Administratori nxjerr bilancin kontabël të Shoqërisë dhe llogarinë "Fitime e humbje", duke u mbështetur në zbatuar rregullat në fuqi dhe ligjet e mbajtjes së kontabilitetit nga subjektet private të përcaktuara nga organet përkatëse.

Bilanci kontabël i Shoqërisë firmoset nga Administratori pas miratimit të tij nga Asambleja e Shoqërisë dhe dorëzohet në organet tatimore të rrethit.

Me kërkesën e ortakëve themelues aktiviteti ushtrimor dhe bilanci i Shoqërisë mund të kontrollohen nga ekspertët kontabël të autorizuar.



N e n i 24

Për specifikat që ka Shoqëria "START-KORÇA" Sh.p.k. si Shoqëri shërbimesh në sektorin e transportit të ~~umdhëtarëve~~, Administratori përpunon dokumentacionin dhe përgatit bilance informative për çdo ortak sipas treguesve dhe në përputhje të plotë me bilancin e përgjithshëm të Shoqërisë.

E njëjta detyrë kërkohet prej tij edhe për treguesit e shpenzimeve, të ardhurave, detyrimeve fiskale dhe detyrimeve të tjera të çdo ortaku të Shoqërisë.

N e n i 25

Të ardhurat e Shoqërisë do të realizohen nga veprimtaria private e saj.

Çmimet dhe tarifatat e shërbimeve do të caktohen me vendim të ortakëve themelues dhe me dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë sistemin e çmimeve.

N e n i 26

Të ardhurat neto që do të rezultojnë pas zbritjes së shpenzimeve, takimit mbi fitimin, detyrimet ligjore për krijimin e fondeve aposipas vendimeve të ortakëve themelues për këtë qëllim, do të mbeten pasuri e ortakëve të Shoqërisë. Kjo pasuri do të ndahet midis tyre në raport me të ardhurat e realizuara nga secili ortak me mjetin e vet.

K R E U I G J A S H T Ë  
" M A R R Ë D H Ë N I E T E P U N Ë S "

N e n i 27

Marëdhëniet e punës në Shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratës së punës të lidhur midis pronarëve të automjetit dhe të punësuarve prej tij. Për problemet që nuk parashikohen në Kontratë zbatohen dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë këto marrëdhënie.

N e n i 28

Shoqëria private "START-KORÇA" Sh.p.k. merr përsipër të respektojë nëpërmjet secilit pronar automjeti ortak të Shoqërisë të gjitha rregullat në fuqi të punësimit, të sigurimeve shoqërore shtetërore për gjithë punonjësit e saj.

Çdo punonjës i punësuar detyrohet të pranojë dhe zbatojë Statutin e Shoqërisë, Aktin e Themelimit të saj, vendimet e Asamblesë së ortakëve dhe dispozitat ligjore në fuqi.

N e n i 29

Mosmarëveshjet midis punonjësve dhe Shoqërisë zgjidhen me mirëkuptim midis tyre dhe një përfaqësie prej 3 ortakësh të caktuar nga ortakët themelues.

Mosmarëveshjet midis punonjësve dhe pronarëve të tyre zgjidhen midis tyre jashtë marrëdhënieve të tyre me Shoqërinë.

Në të dy rastet kur mosmarëveshjet nuk zgjidhen me mirëkuptim, ato zgjidhen nga gjykata e rrethit mbi kërkesën e palës ankuese.

N e n i 30

Të punësuarit përgjigjen sipas ligjit dhe këtij Statuti. Për mosrespektimin e detyrave dhe për dëmet e shkaktuara ata përgjigjen sipas ligjit. Administratori i Shoqërisë ka përgjegjësi civile dhe penale për kryerjen e detyrave të tij.

K R E U I S H T A T Ë  
" SEKRETI I PUNËS "

N e n i 31

Të gjithë ortakët dhe të punësuarit në këtë Shoqëri janë të detyruar të ruajnë sekretin e punës.

Sekret pune paraqitin shkresat, materjalet, aktet dhe vendimet, të cilat me ligje të veçanta dhe me vendime të Asamblesë së ortakëve dhe Administratorit të Shoqërisë janë përcaktuar si sekret pune.

Sekret pune përbëjnë gjithashtu të dhënat informative, bilancet, planet dhe informacionet mbi taktikat ekonomike të Shoqërisë.

Të gjithë të punësuarit janë të detyruar të ruajnë sekretin e Shoqërisë edhe pas largimit të tyre nga kjo Shoqëri.

N e n i 32

Raportimi i të dhënave të ndryshme, të treguesve ekonomikë e financiarë të aktivitetit të Shoqërisë dhe paraqitja e tyre në organet shtetërore dhe tatimore si dhe përfaqësimi i Shoqërisë gjatë procesit të kontrollit të saj është e drejtë ekskluzive vetëm e Administratorit të Shoqërisë.

Çdo raportim tjetër jashtë përcaktimeve më sipër është i palejueshëm dhe i pavlefshëm në ngarkim të Shoqërisë.

K R E U I T E T Ë  
" SHPËRNDARJA E SHQËRISË "

N e n i 33

Shpërbërja e Shoqërisë bëhet në çdo kohë dhe për çdo lloj shkak me vendim të ortakëve themelues të saj.

Mënyrat e likuidimit të Shoqërisë janë kompetencë ekskluzive vetëm e këtyre ortakëve. Ata caktojnë një ose më shumë likuidatorë për të nxjerrë rezultatet përfundimtare të Shoqërisë dhe për të kryer likuidimin e plotë të saj në zbatim të Ligjit nr. 7638 datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregëtare" kreu i IV "Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar".

K R E U I N Ë N T Ë  
" DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME "

N e n i 34

Shoqëria private "START -KORÇA" Sh.p.k. është person juridik i pavarur. Ajo ka të drejta dhe detyrime për të cilat përgjigjet me ligj dhe që janë të parashikuara në Ligjet nr.7512 datë 10.8.1991, nr.7638 datë 19.11.1992 dhe në Kodin Tregëtar.

N e n i 35

Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj privat në bazë të tregut të l. Themeluesit e kësaj Shoqërie e kanë derdhur kapitalin e tyre me qëllim që të fitojnë të ardhura dhe të përballojnë humbje deri në kufirin vlerës së kontributit të tyre në kapitalin e themelimit.

N e n i 36

Shoqëria private "START-KORÇA" Sh.p.k. është person juridik dhe e ton zotësinë juridike për të vepruar nga data e rregjistrimit të saj në Gjykatën e Rrethit të Tiranës si dhe aktivitetin ekonomik me rregjistrimin e saj në Organet Tatimore të rrethit të Korçës.

K R E U I D H J E T Ë

" ORGANIZIMI I BRËNDËSHËM I SHOQËRISË "

N e n i 37

Shoqëria private "START-KORÇA" Sh.p.k. organizon punën **brënda** saj sipas rregullave të përcaktuara në këtë Kapitull, të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga çdo ortak anëtar i saj si dhe nga punonjësit e punësuar në Shoqëri.

Ortakët anëtarë të Shoqërisë gjatë kryerjes së aktivitetit të saj gëzojnë një sërë të drejtash dhe kanë detyrime, për plotësimin e të cilave përgjigjen personalisht.

N e n i 38

Shoqëria mund të shtojë inventarin e autobuzëve dhe mjeteve të tjera nëpërmjet shtimit të automjeteve nga ortakët themelues ose nëpërmjet pronimit në Shoqëri të anëtarëve të rinj së bashku me automjetet e tyre.

N e n i 39

Pamvarësisht që kapitali themelues i Shoqërisë formohet nga vlera e autobuzëve të bashkuar në Shoqëri (përveç kapitalit financiar), secili ortak ka ligjërisht të drejtën e pronësisë mbi automjetin e vet dhe mund të largohet nga Shoqëria duke tërhequr edhe automjetin e vet, mbasi më parë (para 1 muaji) të njoftojë Shoqërinë që po largohet prej saj.

N e n i 40

Në rast largimi të një ose disa ortakëve anëtarë të Shoqërisë "START-KORÇA" Sh.p.k. para afatit të përcaktuar në nenin 4 të këtij Statuti, atëherë më parë do të shlyejnë të gjitha detyrimet e tyre ndaj të tretëve, Shoqërisë dhe sistemit fiskal. Pastaj do të lejohen të tërheqin pjesën e kapitalit që u takon.

Përveç tërheqjes së pjesës së tyre të kapitalit këta ortakë që largohen nga Shoqëria nuk gëzojnë të drejtën të marrin me vete dokumentacionin e Shoqërisë si licenca, etj, i cili i mbetet tërësisht Shoqërisë.

Në rast veprimi në kundërshtim me këtë nen, Shoqëria ka të drejtë të njoftojë me shkrim organet kompetente, duke nxjerrë të pavlefshëm dokumentacionin e marrë arbitralisht nga ortakët e larguar nga Shoqëria.

N e n i 41

N e n i 41

Në rast se autobuzi shitet nga pronari ortak i Shoqërisë "START-KORÇA" Sh.p.k. në një pronar tjetër, në këtë rast autobuzi dhe pronari i tij konsiderohen të larguar nga Shoqëria dhe për dokumentacionin e Shoqërisë qai disponon vepronhet njëlloj siç përcaktohet në nenin 40 të këtij Statuti.

Ripranimi i këtij autobuzi dhe pronarit të tij të ri si ortak në Shoqërinë "START-KORÇA" Sh.p.k. bëhet pas kërkesës me shkrim të pronarit të ri dhe shqyrtimit të saj nga ortakët themelues të Shoqërisë. Shqyrtimi i kërkesës së pronarit të ri nuk do të thotë pranimit i detyrueshëm i tij në Shoqërinë "START-KORÇA" Sh.p.k.

Përjashtim për sa thamë më lart (në rastin e shitjes së autobuzëve) bëhet vetëm kur autobuzi shitet dhe blihet midis dy pronarëve ortakë të Shoqërisë. Në këtë rast autobuzi mbetet detyrimisht në përbërje të Shoqërisë dhe vazhdon punën normalisht në të.

Pronari që shet autobuzin konsiderohet automatikisht i larguar nga Shoqëria.

N e n i 42

- Ortakët anëtarë në Shoqërinë "START-KORÇA" Sh.p.k. kanë të drejtë:
- = Të marrin pjesë në realizimin e veprimtarisë së Shoqërisë dhe të zgjidhen në organet drejtuese të saj.
  - = Të përfitojnë vetë të ardhurat e realizuara nga puna e autobuzëve të tyre, pasi më parë të kenë likuiduar detyrimet që kanë ndaj të tretëve ndaj Shoqërisë dhe ndaj sistemit fiskal.
  - = Ortak anëtar i Shoqërisë mund të bëhet çdo person tjetër që ka dëshirë disponon autobus privat dhe pranon ta bashkojë atë në Shoqëri si ortak të saj. Pranimit bëhet vetëm me vendim të jo më pak se 3/4 të ortakëve themelues të Shoqërisë.
  - = Anëtar i ri i Shoqërisë (bashkëortak) bëhet ai person që pranon dokumentat themeluese dhe të gjitha rregullat e përcaktuara në Shoqërinë "START-KORÇA" Sh.p.k. dhe bashkon kapitalin e vet me kapitalin e Shoqërisë në përmasat që përcaktohen në këtë Statut.

N e n i 43

- Ortakët anëtarë të Shoqërisë "START-KORÇA" kanë këto detyrime:
- = Të ruajnë, zhvillojnë, administrojnë mirë dhe fuqizojnë veprimtarinë e Shoqërisë.
  - = Të respektojnë dhe zbatojnë me përpikmëri dispozitat e Statutit, të Aktit të Themelimit, detyrat e caktuara dhe vendimet e marra nga Asambleja e ortakëve dhe nga ortakët themelues.
  - = Të shlyejnë të gjitha detyrimet që lindin nga puna e autobuzëve të tyre të bashkuar në Shoqëri ndaj Shoqërisë e sistemit fiskal si dhe ndaj punonjësve të marrë prej tyre si të punësuar, të cilët punojnë me autobuzët e tyre.
  - = Të shlyejnë bashkërisht të gjitha detyrimet që lidhen me drejtimin e Shoqërisë, për të cilat kanë vendosur bashkërisht.

N e n i 44

E drejta e bashkëortakërisë në Shoqëri humbet në këto raste:

- = Kur anëtarë i Shoqërisë me vullnetin e tij kërkon largimin prej saj, duke zbatuar rregullat e përcaktuara në këtë Statut.
- = Kur përjashtohet nga Shoqëria me vendim të ortakëve themelues të Shoqërisë për faj të vetë ortakut të përjashtuar.
- = Kur kapitali i tij transferohet sipas rasteve të përcaktuara në ~~pr~~ në 7 të këtij Statuti.
- = Kur ortakut anëtar i Shoqërisë e shet autobuzin e vet.

N e n i 45

Për dëmet që i shkakton Shoqërisë ose ortakëve të veçantë të bashkëortakërisë në të me dashje apo nga pakujdesia, personi shkaktar i çdëmton ato me vullnet të faktike të dëmit. Kur dëmi shkaktohet nga shumë persona, çdëmtimi bëhet nga secili në raport me dëmin e shkaktuar.

N e n i 46

Organizimi i punës në Shoqërinë private "START-KORÇA" Sh.p.k. bëhet nëpërmjet grafikut mujor të përgatitur nga Administratori, i cili ua jep atë të gjithë ortakëve të Shoqërisë.

Grafiku është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga të gjithë ortakët e Shoqërisë.

Thyerja e grafikut mujor, shkelja e destinacionit, hyrja në radhën e shokut pa miratimin e tij e të Administratorit, punimi pa dokumentat e nevojshme të Shoqërisë dhe pa miratimin e saj, dëmtimi i interesave të anëtarëve të tjerë të Shoqërisë me qëllim përfitimi personal, mosdhënia e nevojshme shokut kur ajo është e nevojshme për interesat e udhëtarëve të bashkëortakut, dhe çdo shkelje tjetër e dokumentave themeluesesh e rregullave të brendëshme të organizimit të Shoqërisë të përcaktuara në këto dokumenta si dhe e vendimeve të marra nga Asambleja e ortakëve dhe nga Administratori (sipas kompetencave që kanë) përbëjnë shkelje të rregullave të Shoqërisë "START-KORÇA" Sh.p.k.

N e n i 47

Për të gjitha rastet e thyerjes së rregullave të organizimit të brendëshëm të Shoqërisë përgjegjësia do të kërkohej nga ortakët anëtarë të cilët përgjigjen jo vetëm për shkeljet e tyre por edhe për shkeljet kryera prej punonjësve të punësuar prej tyre.

Përdorimi i autobuzëve jashtë destinacionit të përcaktuar në Liçen e Shoqërisë ngarkon me përgjegjësi pronarin, shoferin, faktorinon, por në asnjë rast Shoqërinë "START-KORÇA" Sh.p.k.

N e n i 48

Ndaj ortakëve anëtarë të Shoqërisë që shkelin rregullat e organizimit të brendëshëm të punës, dokumentat themeluese të Shoqërisë dhe bëjnë shkeljet e përcaktuara në nenin 46 dhe 47 të Statutit, zbatohen këto masa detyruese:

1.- Heqje nga grafiku i punës për 1 muaj.

2.- Heqje nga grafiku i punës për 3 muaj dhe paralajmërim për përjashtim nga Shoqëria.

3;6 Përjashtim përgjithmonë nga Shoqëria "START-KORÇA" Sh.p.k.

Masat detyruese jepen me vendim të ortakëve themelues të Shoqërisë por jo me më pak se 3/4 e tyre.

Vendimet e ortakëve themelues janë të detyrueshëm për zbatim nga të gjithë ortakët anëtarë të Shoqërisë dhe nga drejtuesit e Shoqërisë. Për to njoftohen dhe organet e qarkullimit rrugor të rrethit si dhe organet tatimore.

K R E U I NJËMBËDHJETË  
" DISPOZITA TË FUNDIT "

N e n i 49

Themeluesit e Shoqërisë private "START-KORÇA" Sh.p.k. në rastin e shtimit të ortakëve kanë të drejtë të bëjnë ndryshime në Statut dhe të hartojnë kontrata të përbashkëta me ortakët e tjerë.

Ndryshimet e bëra në Statut duhet të pasqyrohen edhe në Rregjistr Tregëtar pranë Gjykatës së Rrethit të Tiranës.

N e n i 50

Marëdhëniet e kësaj Shoqërie me të tretët dhe me persona fizikë dhe juridikë vëndas ose të huaj do të rregullohen dhe zgjidhen në bazë të marëveshjeve të bëra midis tyre dhe të legjislacionit shqiptar në fuqi

-----  
Ky Statut u hartua në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe. Një kopje e këtij Statuti mbetet si dokumentacion formues në Gjykatën e Rrethit të Tiranës ku Shoqëria rregjistrohet si person juridik dhe një kopje mbahet nga Shoqëria private "START-KORÇA" Sh.p.k. me dokumentacionin e saj themelues.

O R T A K Ë T T H E M E L U E S :

- |            |          |             |           |
|------------|----------|-------------|-----------|
| 1) BENITO  | AZIZI    | 9) ARTAN    | HAMZAT    |
| 2) HASAN   | IBRAHIMI | 10) BARDHYL | META      |
| 3) PIRO    | SARAÇI   | 11) MAKSI   | MARKO     |
| 4) ROMEO   | SARAÇI   | 12) AGRON   | MUÇOLLARI |
| 5) GËZIM   | DVORANI  | 13) PANDI   | BEBA      |
| 6) GJERGJI | BELLO    | 14) PIRO    | NASTO     |
| 7) BUJAR   | GJATA    | 15) SKËNDER | FEKA      |
| 8) GJERGJI | ÇOBO     |             |           |

Korçë më 25 GUSHT 1996